



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2022:272622  
Datë: 14.06.2024  
Numri i dokumentit: 05826392

**C.nr.6914/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Albana Ukshini, në çështjen juridike kontestimore të paditësit–propozueses A.A.B., nga P., me adresë në rr. “...”, nr., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N.P., avokat në P., kundër të paditurit-kundërshtarit të sigurimit B.S.B., nga P., rr. ..., nr..., ose rr..., ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.Rr., nga P., me objekt kontesti pjesëtimin e pasurisë së përbashkët bashkëshortore me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas propozimit të paditëses për caktimin e masës së sigurimit, pas përfundimit të seancës së dëgjimit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar propozimi i paditëses-propozueses A.A.B. nga P., rr..., nr..., përmes së cilit ka kërkuar që të APROVOHET kërkesa e propozueses për caktimin e masës së sigurisë, CAKTOHET masa e sigurimit ndaj kundërpropozuesit B.S.B., nga P., rr..., nr..., duke ndaluar shitjen, tjetërsimin, apo ngarkimin e pronës, si dhe ndërmarrjen e veprimeve ndërtimore në patundshmërinë, me njësinë kadastrale ..., zona rurale, te vendi i quajtur “...”, me kulturë aktuale tokë bujqësore, shfrytëzimi aktual arë e klasës 4, ZK ..., Komuna e P..., në sipërfaqe ... m<sup>2</sup>, dhe njësinë kadastrale ..., zona rurale, sipërfaqja ... m<sup>2</sup> vendi i quajtur “...”, me kulturë aktuale bujqësore, shfrytëzimi aktual arë e klasës 4, ZK ..., deri në vendosjen meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses.

### A r s y e t i m

Paditësja A.A.B., nga P., në këtë gjykatë me datë 20.12.2022, përmes përfaqësuesit të autorizuar N.P., avokat në P., ka paraqitur padi kundër të paditurit B.B., për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët bashkëshortore, ku së bashku me padinë ka paraqitur edhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit përmes të cilit ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit, me të cilën i ndalohet kundërshtarit të masës së sigurisë që të bëjë shitjen, tjetërsimin apo ngarkimin e pronës, si dhe ndërmarrjen e veprimeve ndërtimore për paluajtshmërinë ..., zona rurale, në sipërfaqe ... m<sup>2</sup>, vendi i quajtur “...”, me kulturë aktuale tokë bujqësore, shfrytëzimi aktual arë e klasës 4, ZK ..., P..., dhe njësinë kadastrale ... zona rurale, sipërfaqja ... m<sup>2</sup>, vendi i quajtur “...”, me kulturë

tokë bujqësore, shfrytëzimi aktual arë e klasës 4, ZK ....., deri sa të vendoset në mënyrë meritore për padinë e ushtruar nga paditësi.

I autorizuari i paditëses-propozueses, në padi dhe në propozimin e ushtruar në formë të shkruar, si dhe në seancën e dëgjimit ka theksuar se ndërgjyqësit ishin bashkëshortë në kohën e krijimit të kësaj patundshmerie, gjegjësisht fitimit të kësaj patundshmerie. Ka theksuar se martesë mes ndërgjyqësve është zgjidhur me vendim të gjykatës, dhe derisa të dy patundshmëritë evidentohen në emër të kundërshtarit të sigurimit, pas zgjidhjes së martesës, kundërshtari nuk ka me pengesa ligjore që tjetërsimin eventual apo ngarkimin e patundshmërisë lëndore ta bëjë pa pëlqimin eksplicit të propozueses. Kjo do ta vështirësonte apo pamundësonte realizimin e të drejtës subjektive- e drejta pronësore, për gjysmën e kësaj patundshmerie sipas LFK-se dhe kësaj konsiderojmë se përmbushet edhe pika d e nenit 297 të LPK-se. Pala paditëse-propozuesja në seancën degjimore kishte deklaruar se ekzistojnë faktet të cilat vërtetojnë se jetesa në atë shtëpi ka filluar edhe me herët se të bëjë kurorëzimi. Propozuesja ka theksuar se ekziston dokumenti i cili vërteton marrjen e kredisë për të kontribuar në rregullimin ose mobilimin e shtëpisë, dhe se jetesa në atë shtëpi ka filluar nga viti 2010, ku kanë bashkëjetuar për një vit me palën e paditur-kundërshtarit të sigurimit, pastaj në vitin 2011 ka deklaruar se janë martuar, ku ekzistojnë dhe videoincizimet nëse duhet të përdoren si fakte, dhe kurorëzimi është bërë pas 4 viteve, për shkak të realizimit të disa procedurave mjekësore.

Sa i përket propozimit për masë të sigurisë, ka rrjedhur deri tek ky propozim duke u bazuar në faktin se patundshmëritë janë aktualisht vetëm në emër të të paditurit dhe i padituri ka mundësi të disponojë lirshëm me këto prona, dhe derisa pronat konsiderohen pronë e përbashkët bashkëshortore, duhet të sigurohen në mënyrë që realizimi i tyre mos të vështirësohet apo pamundësohet me ndonjë veprim të të paditurit. Andaj, përfaqësuesi i palës paditëse-propozuesja ka kërkuar që të nxirret masa e sigurisë ndaj kundër propozuesit B.B.

Përfaqësuesi i kundërshtarit të sigurimit, në përgjigje në propozim për caktimin e masës së sigurimit dhe në seancën e dëgjimit, e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit duke theksuar se mungojnë kushtet dhe arsyet e parapara ligjore për caktimin e kësaj mase ndaj patundshmërisë, pasi që kundërshtari nuk ka asnjë interes që patundshmërinë ta shesë apo ta ngarkojë me kurrfarë barre sendore. Po ashtu kishte theksuar edhe faktin se i padituri-kundërshtari i sigurimit me paditësen-propozuesen kanë lidhur martesë 7 vite pasi që kundërshtari e ka blerë patundshmërinë në fjalë, ndërsa shtëpia e ndërtuar është 4 vite para lidhjes së martesës ndërmjet palëve ndërgjyqëse, çka nënkupton faktin se propozuesja nuk ka kontribuar në asnjë rrethanë në blerjen e patundshmërisë apo ndërtimin e shtëpisë, mirëpo të njëjtin shtëpi e ka ndërtuar dhe financuar kundërshtari i sigurimit, për çka gjykatës ka theksuar se i janë paraqitur prova të mjaftueshme, sic janë fatura dhe pagesa të ndryshme të cilat i ka paguar kundërshtari i sigurimit dhe të gjitha janë të paguara në periudhën kohore 2010, përkatësisht 4 vite para lidhjes së martesës. I autorizuari i palës së paditur- kundërshtarit të sigurimit kërkesën për refuzim të masës së sigurimit e kishte kundërshtuar duke vënë në pah faktin se i padituri- kundërshtari i sigurimit ka qene në dijeni që nga viti 2022 për inicimin e këtij kontesti, mirëpo asnjëherë nuk ka ndermarre ndonjë veprim faktik apo juridik për lirimin e pronësisë, përkatësisht ngarkesën e të njëjtës me ndonjë barre juridike, e poashtu as në të

ardhmen i njëjti nuk ka interes që ta ngarkoj me ndonjë barre patundshmërinë, pasi që janë të bindur se baza kryesore e çështjes, përkatësisht kërkesëpadisë është tërësisht joligjore dhe e pabazuar, duke u fokusuar në Ligjin për Familjen e Kosovës, konkretisht nën 47, par.1, në të cilin specifikohet se konsiderohet pasuri e përbashkët e bashkeshortëve. Sa i përket pretendimit se mes palëve ndërgjyqëse është zgjidhur martesja, i autorizuari i palës së paditur kishte deklaruar se nuk qëndron pretendimi i përfaqësuesit të propozueses, pasi që aktgjykimi nuk është i formës së prere, meqë paditësja-propozuesja, atje në kontestin martesor ka paraqitur ankese dhe çështja është ende në procedurë. Bazuar në të gjitha këto, ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet propozimi për masën e sigurisë në tërësi si i pa bazuar.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit i vlerësoj pretendimet e palëve ndërgjyqëse të dhëna në parashtresat e dorëzuara dhe në seancën e dëgjimit si dhe provat e deponuara në shkresat e lëndës, dhe ka gjetur se propozuesja e sigurimit deri në këtë fazë të procedurës nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të saj pasi nga provat e bashkangjitura nga vet propozuesja në propozimin për masë të sigurisë mund të vërtetohet se paluajtshmëria me nr...., si dhe ajo me ... është blerë me datën 11.04.2007 nga kundërshtari i sigurimit ku ky fakt mund të vërtetohet nga certifikatat e pronësisë dhe kontrata e shitblerjes me nr VR.nr...., e vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë, ndërsa nuk është kontestues fakti se martesja ndërmjet ndërgjyqësve është lidhur me datën 27.05.2014 e vërtetuar nga certifikata e martesës e cila gjenden në shkresat e lëndës. Poashtu propozuesja e masës së sigurimit nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e rrezikut të pamundesimit apo vështirësimit të realizimit të kërkesës meqenese në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë konkrete me të cilën do të mund të vërtetohet se kundërshtari i sigurimit ka ndërmarrë ndonjë veprimin me të cilin do të bente tjetërsimin, ngarkimin apo do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese.

Tutje në nenin 297 të LPK-së, është paraparë se *“Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësojë apo vështirësojë dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Në nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit. Ndërsa në nenin 304.3 të LPK-së, është paraparë se *“Propozuesi në propozimin e tij duhet t'i tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”*, si dhe që këto *“mjete provuese t'ia bashkëngjisë propozimit”*.

Sipas dispozitës së lartcekur për caktimin e masës së sigurimit duhet që në mënyrë kumulative të plotësohen dy kushte që propozuesi i sigurimit të bënë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësojë apo vështirësojë dukshëm realizimin e kërkesës.

Nga kjo rrjedhë se caktimi i masës së sigurimit ka për qëllim sigurimin e kërkesës kryesore në rastet kur pala propozuese e bënë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij ku kjo e drejtë subjektive do të mund të vërtetohej përmes ndonjë titulli juridik si, vendim të mëhershëm qoftë të gjykatës apo të ndonjë organi administrativ, kontratë, testament, apo ndonjë dokument tjetër ekzekutiv si dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së këtyllë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës palës paditëse. Gjykata nga shqyrtimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se propozuesja në këtë fazë të procedurës nuk e ka bërë të besueshme kërkesën në shkallën për të cilën kërkohet në mënyrë që të caktohet masa e sigurimit, sepse nuk ka ofruar asnjë prove konkrete relevante që e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së saj subjektive

Përveç faktit së propozuesja nuk e ka bërë të besueshme të drejtën subjektive, e njejta në këtë rast nuk e ka bërë të besueshëm as rrezikun se pa caktimin e masës së këtyllë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, ndërsa propozuesja e sigurimit nuk i ka ofruar gjykatës asnjë provë se kundërshtari i sigurimit deri me tani kanë ndërmarrë ndonjë veprim në drejtim të shitjes, tjetërsimit, ngarkimit apo ndryshimit të gjendjes ekzistuese të ngastrave kontestuese. Sipas vlerësimit të gjykatës për t'u plotësuar kushti i rrezikshmërisë së realizimit të kërkesës, propozuesja duhet që ta provojë faktin së pala kundërshtare ka ndërmarrë ndonjë veprim konkret në drejtim të shitjes, tjetërsimit apo ngarkimit, e jo të mjaftohet vetëm me supozimin së i njejti mund t'i ndërmarrë këto veprime. Kështu, mbi këtë bazë, gjykata pas analizimit të gjendjes faktike të evidentuar në shkresat e lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vë në dukje se vendosja për masën e sigurimit të kërkesëpadisë, nuk ka të bëjë me vendosjen përfundimtare të çështjes kontestuese, dhe nuk është bërë vlerësimi i fakteve në atë formë që në ndonjë mënyrë do të aludonte në vendosjen përfundimtare, por se në këtë fazë gjykata mbështet në dy kushtet e vëna nga neni 297 i LPK-së, që ka të bëjë me bërjen të besueshme të së drejtës subjektive (297.1 pika a), dhe kushti tjetër që ka të bëjë me rrezikun se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte e dukshëm realizimin e kërkesës (neni 297.1 pika b), andaj, gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar të dy kushtet kumulative për caktimin e masës së sigurimit

Nga sa u tha me lart e konform dispozitave ligjore nga neni 387.1 pika (1) lidhur me nenin 142.5 të LPK-s, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.6914/2022, Datë 14.06.2024**

Gjyqtarja  
Albana Ukshini

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.